



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

V E N D I M

Nr. 641, datë 28.12.2020

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONAT E DËMTUARA PIKËSORE, PËR 139 BANESA INDIVIDUALE, BASHKIA KAMËZ”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit Nr.55, datë 30.10.2020 vendosi “Të miratojë rindërtimin në të njëjtin truall, të njësisive individuale të banimit, të vlerësuara "për shembje", sipas kërkesës të Bashkisë Kamëz, me nr. 8373 prot, datë 20.10.2020, për rindërtimin e 139 shtëpive individuale në Bashkinë Kamëz në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Kamëz Nr. 102 datë 31.08.2020, nr. 105 datë 31.08.2020, nr. 125 datë 06.10.2020 dhe vendimit nr. 127 datë 06.10.2020.

VENDOSA:

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 139 banesa Individuale, Bashkia Kamëz, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
 - a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore;
 - b) Materiali hartografik:
 - i. Harta e Përdorimit të Tokës dhe Projektimit Urban;
 - ii. Harta e Infrastrukturave dhe Mbrojtjes së Tokës;
 - c) Paketa e Planvendosjeve për banesat individuale.

2. Miratohet rindërtimi në Zonat e Dëmtuara Pikësore, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, me qëllim rindërtimin e objekteve të cilat referuar akt-ekspertizës së thelluar dhe oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit janë shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 139 banesa Individuale, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.
4. Plani i Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 139 banesa Individuale, të integrohet me dokumentin e Planifikimit në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar.
5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

